



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

URDHËR

Nr. 4098 Prot., Datë 15.07. 2022

PËR

ZGJIDHJEN E MENJËHERSHME TË KONTRATËS INDIVIDUALE TË PUNËS

Bazuar në Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, respektivisht në nenet 153 dhe 154 të tij, Ligjin Nr. 9863 datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, VKM Nr. 708, datë 9.9.2020 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Rregulloren e Brendshme të AKU-së miratuar me urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 297 datë 23.6.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Nenin 16 të Kontratës Individuale të Punës të lidhur me punëmarrësin¹, Relacion Nr. 4098 Prot., datë 15.7.2022 me lëndë “Mbi shkeljet disiplinore të kryera nga Z. Ylli Asanbejlli”,

URDHËROJ:

1. Zgjidhjen e menjëhershme të Kontratës Individuale të Punës ndërmjet punëdhënësit Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe punëmarrësit **z. Ylli Asanbejlli** me pozicion Kryeinspektor në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Fier për shkelje të rënda të akteve ligjore e nënligjore, rregullores së institucionit, urdhrave dhe kushteve të kontratës individuale të punës të kryera me faj të rendë të parashikuara në gërmat “a”, “b” dhe “c” të nenit 16.5 të kontratës individuale të punës.
2. Nga ana e punëmarrësit janë kryer shkelje e renda:
 - a) mospërbushje e detyrave;
 - b) mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;
 - c) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale.
3. Marrëdhëniet e punës dhe financiare të ndërpriten në datën 15.7.2022.

¹ Kontratës Individuale të punës Nr. 1474/1 prot, datë 1.4.2020 dhe Aneks Kontrate Individuale të Punës Nr. 4528/1 prot., datë 26.10.2020.

4. Të merren masa nga ana e punëmarrësit për dorëzimin e detyrës dhe bazës materiale në ngarkim.
5. T'i paguhen ditët e pushimeve vjetore të pa marra për vitin 2022 në raport me ditët e punës të kryera (nëse ka të tilla).
6. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Qarku Fier, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI PËRGJITHSIHËM

